

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar**  
**Mbajtur më datë 26.03.2026**

**Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 09:30, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.**

**Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.**

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA     m
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAJD ZAIMI     m
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA     m

**Sekretare e Këshillit** deklaroi kuorumin prej 12 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema, përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

**Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 10 prot. të datës 19.03.2026.**

Kryetare e Këshillit drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 09:35

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 26.02.2026 dhe 18.03.2026**

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakortësi .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 09:40

Vota pro:12 Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave**

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë nga anëtarët e këshillit nuk ka shprehur konflikt interesi.

### **Pika 4 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2026”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili pyet pse janë penaizuar këto 3 familje?

Fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se janë penalizuar se njëra familje për mos deklarim page, familja tjetër nuk ka shkuar për të bërë gjenerimin e deklaratës së tremujorit, dhe një familje nuk gjendet anëtar i madhor në banesë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se duket pak e çuditëshme për familjen që nuk është gjendur anëtar i madhor në shtëpi. Ndoshta i kanë bërë kontroll në një orë që ai është i pamundur.

Fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se punonjësi ka pasur indicie, në momentin kur ai nuk shkon të gjeneroi deklartën tre mujore atëherë shkon dhe për vizitë në familje e njofton dhe në telefon dhe kur nuk e gjen ka të drejtë ta heqi sepse ai mund të jetë jashtë shtetit. Ne ka raste që dhe ju themi mund të vini brenda kësaj date që të hedhim dhe vizitën në sistem. Ju sigurojmë që i marim në telefon deri sa të vinë.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 09:55

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Pika 5 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin Shkurt 2026”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:10

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 6 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Albert Braçaj”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Pëllum Guri i cili shpreh se Z. Albert Braçaj e njoh dhe ka vërtetë shumë nevojë pasi ka bërë shpesh herë operime plus është dhe njeri i vetëm. Për mua do ishte më mirë që ti shtohet akoma më shumë ndihma.

Fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se është dakort me dhënien e ndihmës pasi ai vetëm një përkrahje 30 milionë mer dhe nuk e di se si mund tja dali .

Fjalën e mori Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shprehu se më mirë ti japim edhe një herë tjetër ndihmë se sa të prishim një standart që kemi vendosur .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:15

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 7 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Kastriot Metaj”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:20

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 8 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Neshat Gorçe”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:25

Vota pro: 12. Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 9 e rendit të ditës “Për miratimin e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh meqenese shpreve se se janë tavanet pergatitore te 2027-2029 mbaro njehere me 2026 se ke koh të besh ndryshime dhe ti shohim vit mbas viti neqoftese do vazhdojme te jemi.Ose per gjendjen aktuale që jemi tani the që do mbajmë të njejtin numër punonjesish dhe do bësh të njejtat invenstime kur invenstimet i ke zero domëthënë që dhe 2027-2029 ti prap zero i ke inevenstimet.

Fjalën e mori z. Neim Gogo, i cili sqaroi se, me numrin aktual të punonjësve dhe nivelin ekzistues të pagave, pjesa më e madhe e buxhetit shkon për paga dhe sigurime shoqërore. Ai theksoi se për vitin 2026 investimet e garantuara arrijnë në rreth 65,622,000 lekë të reja, të cilat nuk janë të pakta.

Fikret Telha :çfarë të presim kur ka tre muaji që ka dalë vendimi për ngritjen e pagës minimale dhe ti ske bërë akoma ndryshimin, je e vetmja bashki dje kamë parë të paktën 10 bashki që e kishin realizuar rritjen e pages minimale. Domethene me kete ecuri qe ke ti, ti puntorët në fund te vitit i le 2-3 muaji pa paga. Duke mos ngritur pagat e punonjesve tani i bie që jeni keq me hartimin. Perderisa nuk po ngrini pagat e punonjësve ini e vetmja bashki që spo i ngrini, po funksionet e deleguara cafrë po bëni?

Neim Gogo: shpjegon se vendimi për rritjen e pagës minimale nga 40.000 në 50.000 mijë ky vendim automatikisht është i zbatueshem sepse dhe sikur mos te duash sistemi taimeve nuk të lejon te deklarosh sigurime me pagë 40.000 mije lekë. Kështu që paga minimale është rritur, nuk ka asnjë punonjës në bashki që të mari me pak se 50.000 mije lekë bruto. Rritja e pagave sipas një vendimi tjetër të Këshillit të Ministarve pagat e punonjësve që janë me klasa ktu po vlen të diskutohet dhe ne jemi të ndërgjegjshëm për këtë, që fondet për të rritur pagat e punonjësve të cilët paguhen nga xhepi i bashkise, nuk kemi. Sepse kur kemi bërë buxhetin e 2026 që e kemi miratuar në 22 dhejtor 2025 VKM-ja për rritjen e pagave nuk ishte dhe unë nuk kisha si ta parashikoja këtë rritje. Kështu që ne buxhetin e 2026 ne nuk kemi parashikuar fonde shtesë për rritjen e pagave sipas një vendimi që del në 2026.

Fikret Telha po si do e perballosh si do veprosh?

Neim Gogo: me fondet e deleguara ne jemi të detyruar që ti paguajmë ti rrisim që është arsimi 9-vjeçar, arsimi parashkollor, konvikti, funksionet e transferuara në 2016 do ti shikojmë dhe do ti marim në konsideratë. Ndërsa për punonjësit që paguhen me fondet e buxhetit bashkisë nga të ardhurat dhe nga granti ne nuk kemi mundesin që ti rrisim. Sepse nuk mund të rrisim paga dhe pastaj në fund të vitit të mos harrijmë të paguajmë ato dy muajt e fundit. Pse ndodh kjo ? Kjo ndodh sepse nga 360 punonjës të bashkisë, 216 janë me arsim të mesëm dhe përfitojnë nga rritja e pagës minimale, gjë që krijon një kosto shtesë shumë të lartë financiare. Sipas përlllogaritjeve, rritja mesatare e pagës së bashku me kontributet shoqërore dhe shëndetësore sjell një kosto shtesë të konsiderueshme për buxhetin vendor. Për këtë arsye, alternativat do të ishin reduktimi i numrit të punonjësve ose ulja e shpenzimeve operative, çka do të ndikonte drejtpërdrejt në shërbimet ndaj komunitetit. Që të ulësh shpenzimet operative do të thotë të mos kryesh shërbimet e planifikuara ndaj komunitetit ndaji me mirë me këtë nivel pagash.

Fikret Telha: ka dhe dicka që ka punonjës që nuk vinë në punë edhe i paguan? Ke listën.

Neim Gogo: u shpreh se kjo çështje nuk është në kompetencën e tij dhe se lista përkatëse administrohet nga drejtoria përgjegjëse.

Fikret Telha: silleni listën këtu në këshill edhe i kalojmë.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:35

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: 1 Fikret Telha

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 10 e rendit të ditës “Për strehimin e familjeve në nevojë, Kastriot Hidërshaj dhe Riza Liçollari në objektet e kthycera në fond banese me vendim të Këshillit Bashkiak nr.62, datë 27.11.2025” Për kthimin në fond banese të dy objekteve: ish-kopshti i fëmijëve në lagjen “Hasan Seitaj” dhe ish zyrat e vjetra të Ndërmarrjes Pyjore, për qëllime strehimi”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj.Rudina Llango e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se janë shumë dakort dhe të ndihmoen sa më shumë familje në nevojë.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili nëse ka pasur kërkesa të tjera për strehim apo jo?

Fjalën e mori znj.Rudina Llango po ju shpjegoj se Bashkia Skrapar është duke bërë verifikimin e disa pronave që mund të kthejmë në fond banese për familjet që do të kanë nevojë për strehim. Aktualisht në Bashkinë skrapar nuk kemi kërkesa të mirëfillta për strehim të mirëfilltë, por kanë sjellë kërkesa të tipit rikonstruksion të një banese të rrëzuar. Ndërsa kërkesa për çiftet e reja në aplikimet që bëhen nëpërmjet sistem nuk ka pasur. Për të gjitha ato objekte që ne do të shohim të arsyeshme për ti kthyer në fond banese do të ndiqen procedurat përkatëse..

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:45

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

### **Të ndryshme**

Fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shprehu disa probleme:

Kërkoj marrjen e masave për zgjidhjen e problematikës së bllokimit të rrugës pedonale, duke propozuar përcaktimin e një orari të posaçëm për lejimin e hyrjes së automjeteve, me qëllim furnizimin normal të të gjitha subjekteve tregtare, në mënyrë që bizneset të mos detyrohen të transportojnë mallrat manualisht. Theksoj nevojën që çelësi i aksesit të mos administrohet vetëm nga një subjekt i vetëm, por të gjendet e barabartë për të gjitha bizneset.

Ngriti shqetësimin mbi rrëshqitjen e murit mbajtës në lagjen e Moza Zylyftarit, duke kërkuar ndërhyrje të menjëhershme dhe marrjen e masave për sistemimin e situatës.

Gjithashtu, sugjeroi që brigada e ndërtimit të funksionojë nën drejtimin e Këshillit Bashkiak.

Fjalën e mori Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shprehu se nuk mund të drejtohej brigada e ndërtimit nga këshilli kjo për arsye administrative dhe për arsye të specifikes së punës. Ndërsa për sa i përket lagjes ku është rrëzuar muri ne e kemi parë e kemi studiuar që atë ditë por sot është bërë i disponueshëm fondi ardhur nga emergjencat civile. Është i ndarë në dy pjesë një pjesë është për investime dhe pjesa tjetër është për rasate të tilla që sapo u përmend.

**Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .**

**Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela**

**Kryetare Këshillit Bashkiak:**

**Elsa Petritaj**

**Këshilltarët që firmosin procesverbalin:**

1. Alma Kadasi

2. Fikret Telha

3. Skerdilajt Jaupllari